

VENDIM
Nr.524, datë 15.8.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË FINANCIVE, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 14 (katërmëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Adresa: Rr.Sami Frashëri, Tiranë, fax 00355 4 253 820

Lënda: Pergatitja dhe dergimi i dokumentacionit te
Inventarizimit te pronave publike

1

Aparati Drejtorise se Pergjithshme te Doganave

TIRANE